

## DEKRET

### “PËR

### EMËRIMIN E GJYQTARIT TË GJYKATËS KUSHTETUESE”

Në mbështetje të nenit 93, 125 pikat 1 dhe 3, 129, 179 pikat 2 dhe 12, të Kushtetutës së Shqipërisë, neneve 7, 7/a pika 4, 7/b, 8 dhe 86 pika 4, germa “a” të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, pasi administrova në datë 08.10.2019 “Listën Përfundimtare të Renditjes së Kandidatëve të lejuar për kandidim dhe Raportin e Arsytuar të Renditjes së tyre, për plotësimin e vendit vakant në Gjykatën Kushtetuese (vakancë e plotë) e shpallur nga Presidenti i Republikës me Dekretin nr. 10722, datë 07.02.2018”, akte këto të miratuara nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi me Vendimin nr. 128, datë 21.09.2019 dhe Vendimin nr. 129, datë 21.09.2019, si dhe pasi u njoha me përmbajtjen e praktikës dokumentare të vendimmarrjes dhe vlerësimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi për kandidatët e ngelur në garë për plotësimin e kësaj vakance dhe të renditur në tri vendet e para të listës, përcjellë nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi me shkresë nr. 552 prot., datë 08.10.2019, në përfundim vendosa të,

### *D e k r e t o j ;*

#### **Neni 1**

Zoti Besnik MUÇI emërohet gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese.

#### **Neni 2**

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**Nr. Dekretit 11313**

**Tiranë, më 15.10.2019**

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS**

**ILIR META**

**ARSYET “PËR PËRZGJEDHJEN E KANDIDATURËS TË ZOTIT BESNIK MUÇI, PËR T’U EMËRUAR GJYQTAR NË GJYKATËN KUSHTETUESE”**

Presidenti i Republikës nëpërmjet Dekretit nr.10722, datë 07.02.2018, ka vendosur, “Shpalljen e procedurës së thirrjes për aplikim për plotësimin e vendit vakant gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, vakancë kjo e cila ishte krijuar për shkak të përfundimit të mandatit të ish-gjyqtarit zotit Sokol Berberi.

Kjo shpallje për aplikim u publikua sipas kërkesave të ligjit, që prej datës 08.02.2018 në mjetet e informimit public, si në faqen zyrtare të Institucionit të Presidentit të Republikës, në Qendrën e Botimeve Zyrtare (QBZ), në portalin e Shërbimit Kombëtar të Punësimit, në buletinin e Agjencisë së Prokurimit Publik (APP) dhe u shpërnda në gjithë median e shkruar dhe vizive.

Gjithashtu, njoftimi ka qenë i publikuar në shtypin e shkruar nga data 9 deri në datën 13 shkurt 2018, në gazetatat “Panorama”, “Gazeta Shqiptare” dhe “Koha Jonë”.

Në përfundim të afatit ligjor të shpalljes dhe administrimit të aplikimeve për plotësimin e kësaj vakance, aplikuan gjithsej **22 shtetas**, ku për secilin prej tyre është mbajtur një procesverbal për inventarizimin e të gjithë dokumentacionit që përmbante dosja e aplikimit, të dorëzuar në Institucionin e Presidentit të Republikës.

Menjëherë pas përfundimit të afatit të aplikimit, në përputhje me përcaktimet e nenit 234 pika 1 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në faqen zyrtare të Institucionit të Presidentit të Republikës është publikuar lista e të 22 aplikantëve, të cilët kishin shprehur interesit për të konkuruar për plotësimin e kësaj vakance.

Institucioni i Presidentit të Republikës, me shkresën **nr. 2668/2 prot., datë 28.02.2018** “Njoftim për dorëzimin e aplikimeve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese” dhe shkresën **nr.2668/4 prot., 01.03.2018** “Mbi dorëzimin e listës së aplikimeve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese”, ka përcjellë pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi listat e aplikantëve për vendin vakant gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Presidenti i Republikës me Dekretin nr. 10722, datë 07.02.2018.

Gjithashtu, nëpërmjet këtyre shkresave, Institucioni i Presidentit të Republikës i ka kërkuar Kryetarit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi të thërrasë mbledhjen e Këshillit për fillimin e shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar për verifikimin, vlerësimin, listimin dhe miratimin e kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese me qëllim plotësimin e vakancave të krijuara.

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, i zgjedhur për të funksionuar përgjatë vitit 2018, u mbledh në datë 19 mars 2018, mbledhje kjo, ku ky organ është konstituuar. Më pas, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi nuk është mbledhur më asnjëherë përgjatë gjithë periudhës deri më 31 dhjetor 2018, kohë kjo që përkonte edhe me përfundimin e mandatit të tij.

Presidenti i Republikës, ka mbajtur qëndrim publik mbi faktin e bllokimit të veprimtarisë së të dy Këshillave të Emërimeve në Drejtësi të zgjedhur me short nga Kuvendi i Shqipërisë për të funksionuar përgjatë viteve 2017-2018, gjë e cila solli si rezultat mosshqyrtimin e kandidaturave dhe mosplotësimin e vendeve vakante të krijuara në Gjykatën Kushtetuese dhe daljen jashtë funksionit të kësaj gjykate, për shkak të humbjes së kuorumit vendimmarrës të saj, në muajin mars 2018.

Pikërisht mosfunksionimi i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi për dy vite radhazi (2017-2018) bëri që edhe pse kanë kaluar 19 muaj nga publikimi dhe hapja e thirrjes për aplikim (shkurt 2018) për këtë vakancë dhe vakanca të tjera të shpallura për aplikim nga Presidenti i Republikës, deri më datë 8 tetor 2019, nuk u paraqitën lista me kandidatë për plotësimin e vakancave të krijuara.

Në këto kushte, vendi aktualisht ndodhet në një situatë emergjence të krijuar subjektivisht për shkak të bllokimit dhe mosfunksionimit të Këshillit përgjatë viteve 2017-2018.

Ndërkohë Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, i zgjedhur për ushtrimin e mandatit për vitin 2019 ka filluar veprimtarinë në datë 15 janar 2019.

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, ka kryer verifikimin, vlerësimin dhe renditjen e kandidatëve për vendin vakant gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese të shpallur nga Presidenti i Republikës me Dekretin nr. 10722, datë 07.02.2018.

Në përfundim të këtij procesi, rezultoi se janë lejuar për kandidim dhe kanë ngelur në garë vetëm **4 (katër) kandidatë**, nga **22 aplikantë** që shprehën interesin.

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, me shkresën nr. **552 prot., datë 08.10.2019**, administruar me nr. 3534, datë 08.10.2019, ka përcjellë pranë Institucionit të Presidentit të Republikës “Listën

Përfundimtare të Renditjes së Kandidatëve të lejuar për kandidim dhe Raportin e Arsyetuar të Renditjes së tyre, për plotësimin e vendit vakant në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e plotë, të shpallur nga Presidenti i Republikës me Dekretin nr. 10722, datë 07.02.2018”.

Nga shqyrtimi i praktikës rezultoi se:

1. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi me Vendimin nr. 128, datë 21.09.2019, ka miratuar “Listën përfundimtare të renditjes së kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, në vendin vakant, vakancë e plotë, të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018”;
2. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi me Vendimin nr. 129, datë 21.09.2019, ka miratuar “Raportin për renditjen e kandidatëve të lejuar për plotësimin e vendit vakant të krijuar në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e plotë, të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018”.

Bashkëlidhur praktikës së dërguar janë përcjellë nga KED të gjitha vendimet e tjera të marra nga ky organ për lejimin e kandidimit, vlerësimin dhe pikëzimin e katër kandidaturave të ngelur në garë. Ndërkohë, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ka përcjellë gjithashtu edhe vendimet e tij për ndalimin nga kandidimi të 14 aplikantëve, si dhe vendimet për përfundimin e procedurës së verifikimit për shkak të dorëheqjes nga kandidimi të 4 (katër) kandidatëve.

Me Vendimin nr. 128, datë 21.09.2019, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ka miratuar “Listën përfundimtare të renditjes së kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, në vendin vakant, vakancë e plotë, të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018” me këtë renditje;

1. Arta Vorpsi 89.642 pikë
2. Elsa Toska 85.428 pikë
3. Besnik Muçi 81.928 pikë
4. Regleta Panajoti 80.285 pikë

Presidenti i Republikës, pasi shqyrtoi praktikën dhe dokumentacionin e përcjellë nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në përfundim ka vendosur të përzgjedhë kandidatin Besnik Muçi për t’u emëruar gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, kryesisht mbështetur në këto arsye të cilat evidentohen dhe janë vlerësuar edhe më hollësisht nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi në vendimet e tij.

Zoti Besnik Muçi është diplomuar në vitin 1995 “Jurist”, në Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin e Tiranës, me rezultate të shkëlqyeshme.

Në vitin 2001 zoti Muçi ka përfunduar studimet në Shkollën e Magjistraturës dhe është diplomuar “Magjistrat Prokuror” me rezultat “Shumë mirë”.

Zoti Besnik Muçi ka ndjekur studime pasuniversitare për Master të Nivelit të Dytë në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti I Tiranës, si dhe aktualisht është Kandidat Doktorant pranë këtij Fakulteti. Ai është botues i disa artikujve shkencor në fushën e së drejtës, si dhe botues i një libri në fushën e veprave penale të narkotikëve.

Zoti Muçi ka një eksperiencë pune prej më shumë se 20 vitesh (20 vite e 8 muaj), si Prokuror, Avokat dhe Lektor i së Drejtës. Ai ka një veprimtari profesionale si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, prokuror pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë, Drejtor i Drejtorisë kundër Krimit Financiar, në Departamentin e Hetimit të Krimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, ekspert i programit për trajnimin vazhdues të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Shkollën e Magjistraturës, Petagog i Jashtëm i lëndës “E Drejta Penale”, në një nga Universitetet e vendit.

Zoti Besnik Muçi në karrierën e tij si Prokuror ka përvojë të konsoliduar në hetimin e krimit të organizuar dhe organizatave kriminale, fakt ky që përbën një vlerë të shtuar për trupën gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, e cila në praktikën e saj përballet me shqyrtimin e çështjeve të nivelit kushtetues që lidhen me fushën e drejtësisë penale.

Përgjatë periudhës së punës së tij në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda janar 2014 – gusht 2019 ai ka hetuar gjithsej 275 procedime penale objekt i hetimit dhe veprimtarisë së Prokurorisë së Krimeve të Rënda, një tregues i lartë ky i angazhimit dhe vendimmarrjes profesionale.

Për shkak të karrierës së tij si Prokuror, zoti Besnik Muçi ka përfituar një përvojë të vlerësueshme në fushën e marrëdhënieve juridikionale me autoritetet e huaja gjyqësore në kuadër të kryerjes së veprimeve hetimore proaktive dhe të përbashkëta, të cilat kanë perfeksionuar aftësitë e tij profesionale në fushën e drejtësisë penale, respektimit dhe garantimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në procesin penal.

Zoti Besnik Muçi ka qenë ekspert i Komitetit MONEYVAL të Këshillit të Europës, si përfaqësues i Ministrisë të Brendshme. Gjithashtu, prej vitit 2014, ai është Ekspert i Konferencës së Palëve të Këshillit të Europës për zbatimin Konventës së Varshavës, si përfaqësues i Prokurorisë së Përgjithshme. Gjithashtu zoti Muçi përgjatë viteve 2015-2018 ka qenë dhe Anëtar i Bordit të Konferencës së Palëve të Këshillit të Europës për zbatimin e Konventës së Varshavës, si përfaqësues i Prokurorit të Përgjithshëm të Shqipërisë.

Zoti Besnik Muçi gëzon integritet të lartë moral, etik dhe cilësi të larta profesionale, të cilat janë kërkesa të domosdoshme dhe në koherencë me besimin që kërkon publiku për të qenë anëtar i Gjykatës Kushtetuese. Ai, përgjatë karrierës së tij ka reflektuar aftësi vendimmarrëse dhe bashkëpunimi. Në lidhje me këto kushte dhe kritere që duhet të plotësojë një kandidat për të qenë anëtar i Gjykatës Kushtetuese, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi për kandidaturën e zotit Besnik Muçi është shprehur qartë dhe ka bërë vlerësimet përkatëse në Vendimin nr. 72, datë 24.07.2019 për “Lejimin e kandidimit të zotit Besnik Muçi në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018” dhe në Vendimin nr. 123, datë 10.09.2019, për “Vlerësimin dhe pikëzimin e kandidaturës së zotit Besnik Muçi për vendet vakante për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese..”.

Një arsye me rëndësi të veçantë dhe delikate në përzgjedhjen e kësaj kandidature është respektimi i frymës dhe përcaktimeve të nenit 7/a, pika 4 dhe nenit 7/b, pika 3 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ku përcaktohet se: **“Organet e emërtesës marrin parasysh përbërjen e Gjykatës Kushtetuese në momentin e emërimit të kandidatit për të garantuar balancën ndërmjet përvojave profesionale të anëtarëve dhe respektimin e barazisë gjinore”.**

Vullneti i ligjvënësit për të garantuar balancën e përvojave profesionale në trupën gjyqësore kushtetuese evidentohet edhe në nenin 7/b, pika 3 të ligjit nr.8577/2000, ku citohet se: **“3. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, pas vlerësimit të kushteve dhe të kriterëve të emërimit, brenda 10 ditëve nga zhvillimi i mbledhjes harton një listë përfundimtare duke renditur kandidatët. Nëse ka më shumë se një vend vakant, Këshilli harton dy lista të veçanta, një prej të cilave është me kandidatët që vijnë nga radhët e Gjyqësorit.”**

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi nuk ka mundur të përmbushë këtë kërkesë të ligjit, edhe pse dispozita e mësipërme dikton ndjekjen e kësaj procedure me qëllim që përbërja e Gjykatës

Kushtetuese të pasqyrojë një trupë të kombinuar gjyqësore ku duhet të gjejnë vend kandidatë që vijnë nga radhët e sistemit të drejtësisë, magistrat (gjyqtar/prokuror).

Edhe pse Këshilli i Emërimeve në Drejtësi nuk ka mundur të përmbushë këtë kërkesë të ligjit Presidenti i Republikës, ka vlerësuar me shumë vëmendje plotësimin edhe të këtij vullneti të ligjvënësit të shprehur në ndryshimet që pësoi ligji nr.8577/2000, në kuadër të reformimit të sistemit të drejtësisë në vitin 2016.

Në kushtet kur zoti Besnik Muçi është i vetmi kandidat magistrat (Prokuror) i përfshirë në tri vendet e para të listës së kandidatëve për plotësimin e kësaj vakance, dhe në kushtet kur ai është dhe kandidati i vetëm i gjinisë mashkullore, atëherë këto janë disa arsye më shumë ligjore dhe objektive për përzgjedhjen e kësaj kandidature duke plotësuar njëkohësisht dhe kërkesat dhe frymën që dikton ligji nr.8577/2000.

Duke vlerësuar shumë të rëndësishëm rolin dhe rëndësinë që ka Gjykata Kushtetuese në mirëfunksionimin e shtetit të së drejtës, Presidenti i Republikës ka vendosur që të shprehet pa vonesë për emërimin e kandidatit të përzgjedhur prej tij, në mënyrë që kjo vendimmarrje të pasohet me një vendimmarrje të Kuvendit të Shqipërisë në zgjedhjen e anëtarit tjetër të Gjykatës Kushtetuese, me qëllim që Gjykata Kushtetuese të jetë sa më shpejt funksionale e aftë për të marrë vendime dhe për t'u dhënë zgjidhje kushtetuese një sërë çështjeve që shqetësojnë të gjithë jetën shoqërore në vend.

Për gjithë sa u parashtrua më sipër, në mbështetje të nenit 93, 125 pikat 1 dhe 3, 129, 179 pikat 2 dhe 12, të Kushtetutës së Shqipërisë, neneve 7, 7/a pika 4, 7/b, 8 dhe 86 pika 4, germa "a" të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, Presidenti i Republikës në cilësinë e organit të emërtesës ka vendosur që nga lista përfundimtare e përcjellë nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi nga kandidatët e renditur në tri vendet e para të listës të përzgjedhë dhe të emërojë **zotin Besnik MUÇI**, gjyqtar të Gjykatës Kushtetuese.

**Tiranë, më 15.10.2019**

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS**  
**ILIR META**